

**URDHËR**  
**Nr. 515, datë 7.9.2023**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME  
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E  
HUNGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
  - b) zogjve 24-orësh;
  - c) shpendëve dekorativë;
  - ç) materialit biologjik të shpendëve;
  - d) vezëve të shpendëve;
  - dh) mishit të shpendëve;
  - e) nënprodukteve të shpendëve,
- nga shteti i Hungarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Ndarja Administrative e Nivelit 1 | *Ndarja Administrative e Nivelit 2 | Ndarja Administrative e Nivelit 3 |
|-----|-----------------------------------|------------------------------------|-----------------------------------|
| 1   | Csongrád-Csanád                   | Szentes                            |                                   |
| 2   | Nógrád                            | Salgótarján                        |                                   |

*Shënime. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 422, datë 14.7.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
**Frida Krifca**